

**RAPORTI I AUDITUESIT**  
**MBI VERIFIKIMIN E VEPRIMEVE NE BAZËN E TE DHËNAVE TE**  
**REGJISTRIT KOMBËTAR TE GJENDJES CIVILE**

Përgatiti:  
Laert Kraja  
Audit Teknikien



Lënda : **Raporti Auditimit**

Drejtuar : **Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**  
**Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror për Zgjedhje**

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 82, datë 15.07.2024, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë. dhe udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju paraqes më poshtë raportin e auditimit të kryer për listën e datës 10 Korrik 2024.

Verifikimet paraprake mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhore e listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) në zbatim të "Kodit Zgjedhor", Ligjit "Për Gjendjen Civile", janë kryer duke përdorur metodën e testimit dhe krahasimit nëpërmjet përkëmbimeve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Për përmbushjen e misionit të ngarkuar kam vlerësuar metodat dhe parimet e përdorura për kontrollin e dublimeve në listat e zgjedhësve sipas procedurave të parashikuara në aneksin nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", respektimin e kriterit ligjor për numrin e zgjedhësve për qendrat e votimit si dhe kriteret e tjera të vendosur në ligj.

Përgjegjësia e audituesit është të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për "Gjendjen Civile" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.



## **Përmbajtje**

1. Hyrje.....	4
2. Baza Ligjore .....	6
3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake .....	7
4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.....	10
4.1. Shtetas të së njëjtës familje por votojnë në QV të ndryshme .....	10
4.2. Ndryshimet e listës krahasuar me Listën e vitit 2023.....	10
4.3. Sistemi i Adresave .....	11
5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore .....	15
6. Opinion .....	15
7. Shtojca .....	16



## 1. Hyrje

Ne kuadër të zgjedhjeve, sipas dekretit Nr.244 të Presidentit të Republikës, datë 05.07.2024, do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024 nëpërmjet vendimit Nr. 85, datë 15.07.2024, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve është bere caktimi i auditit teknikien.

E gjithë puna është bazuar dhe do të bazohet në përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për Miratimin e Rregullave të Veçanta,për Kushtet e Kontratës dhe Kryerjen e Auditimit, nga Auditët Teknikien, për Verifikimin e Veprimeve në Bazën e të Dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe në Sistemin Elektronik të Verifikimit dhe Regjistrimit Të Zgjedhësve (SEV)"; i cili në nenin 7 përcakton objektin, në lidhje me verifikimet e veprimeve në bazën e të dhënave, si më poshtë:

*Objekt i auditimit nga auditët teknikien është kontrolli i përputhshmërisë së veprimeve të kryera për hartimin e listave të zgjedhësve nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me rregullat dhe afatet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për Gjendjen Civile si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre të nxjerra nga Ministri i Brendshëm.*

Me qëllim realizimin e këtyre objektivave, puna jonë është përqendruar në verifikimin e të gjithë elementëve të listave të zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në lidhje me ekzistencën dhe saktësinë e të dhënave për të gjithë ata shtetas të cilët gëzojnë të drejtën që të jenë zgjedhës, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.

Në zbatim të detyrës të caktuar kontrolli i ekstraktit të përbërësve zgjedhor përfshin në përgjithësi:

- Njohjen dhe verifikimi i procedurave të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë të Brendshme, Zyrrave e Gjendjes Civile pranë Bashkive dhe Njësi Administrative, si dhe të strukturave të tjera të pushteti vendor, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në përgatitjen e listës së zgjedhësve.

- Verifikimi mbi masat e ndërmarra për sigurimin e integritetit të bazës së të dhënave dhe mbi procedurat e mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.
- Kryerjen e verifikimeve mbi veprimet kryera nga shërbimi i Gjendjes Civile të cilat ndikojnë në elementët zgjedhorë, sipas përcaktimeve të nenit 45, të ligjit nr. 10019 me datë 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndryshuar.



## 2. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.07.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"
- VKM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik".
- VKM Nr.673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'"
- VKM Nr. 710 datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit" i ndryshuar,
- VKM 222 date 26.4.2018 "Për miratimin e listës se infrastrukturave kritike te informacionit dhe listës se infrastrukturave te rëndësishme te informacionit"
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.113, datë 09.07.2024 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për kryetar të bashkise Himarë, Qarku Vlorë"
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit

Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)

### 3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake

Duhet theksuar që në fillim se me marrjen e detyrës kemi zhvilluar takimin e parë më datë 17 Korrik 2024, me zyrtarët kryesorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të siguruar kushtet minimale të punës dhe për të marrë informacionet bazë të nevojshme për zhvillimin e punës sonë. Që në takimin e parë dhe në vazhdim janë kërkuar

1. Përcaktimi i një posti pune pranë DPGJC dhe aksesit në Sistemin Informatik të Regjistrimit Kombëtar të Shtetasve, dhe/apo sisteme të lidhura me të.
2. Kopje zyrtare të Listës së Zgjedhësve për Bashkinë Himarë dhe statistikat përkatëse.
3. Informacion mbi procesin e përditësimit të adresave të shtetasve.
4. Statistika mbi të dhënat për QV-të të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore.

Gjithashtu më datë 17 Korrik 2024 kemi marrë ekstraktet e përbërësve zgjedhorë të gjeneruara në datën 10 Korrik 2024 si edhe statistikat nga DPGJC në po të njëjtën datë.

Bazuar në statistikat e përgatitura nga ana DPGJC-së të ekstraktit të gjeneruar në datën 10 Korrik 2024 i cili është gjithashtu dhe lista përfundimtare pasi për zgjedhjet e pjesshme të bashkisë Himarë gjenerohet vetëm një ekstrakt, nga RKGJC. Nga DPGJC, na janë venë në dispozicion të dhënat si më poshtë:



Nr	Përshkrimi	Lista Përfundimtare
1	Numri i përgjithshëm i shtetasve me të drejtë votimi	23.074
	a. Meshkuj	11.598
	a. Femra	11.476
	b. Votues për herë të parë	385
2	Të pa përfshirë në lista (total):	136
	a. Shtetas mbi 100 vjeç të pa përfshirë	136
	b. Shtetas të pa përfshirë sipas udhëzimit nr. 225 datë 11.05.2016	-
	c. Të tjerë me numër QV jashtë limitit	-
3	Numri i Votuesve në listë	23.074
4	Numri i QV-ve në total	36
5	Numri i QV-ve mbi 1,000 zgjedhës	-
6	Numri i QV-ve nën 300 zgjedhës, nga të cilat	-
	a. 15-300 zgjedhës (QV të veçanta)	-
	b. Më pak se 15 zgjedhës	-
7	Numri i zgjedhësve me numër banimi 000 888 999	119

Në një vështrim të përgjithshëm nga treguesit e mësipërm rezultojnë se:

1. Numri total i shtetasve me të drejtë vote në Listën përfundimtare është **23.074** zgjedhës.
2. DPGjC dhe Bashkia kanë eliminuar 100% të qendrave të votimit me më pak se 300 votues dhe më shumë se 1000 votues, gjithashtu dhe QV me më pak se 15 zgjedhës kemi 0 QV, të cilat janë numra të gabuar dhe jashtë njësisë Administrative respektive, janë pastruar plotësisht.



3. Vazhdon të jetë prezent numri i shtetasve me kodet banimi 000, 888 dhe 999. **119** shtetas janë të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve.
  
4. Janë **136** shtetas mbi moshë 100 vjeç të pa përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve.

#### 4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.

##### 4.1. Shtetas të së njëjtës familje por votojnë në QV të ndryshme

Shtetasit me të njëjtin kod të vendbanimit (brenda trungut familjar) duhet të jenë votues në të njëjtën Qendër Votimi. Pas një kontrolli mbi kodet e banimit vejmë re se kemi **157** raste të votuesve me të njëjtin kodbanimi por votojnë në Qendra Votimi të ndryshme.

Bashkia	Nr i rasteve qe I njëjti kod banimi ndodhet në dy ose më shumë fraksione
Bashkia Himarë	157

##### 4.2. Ndryshimet e listës krahasuar me Listën e vitit 2023.

Nga analiza e të dhënave dhe të listës **Përfundimtare** të vitit **2023** dhe Listës së datës **10 korrik 2024** të votuesve ne Bashkinë Himarë, rezultojnë se në bashkinë Himare numri i votuesve është rritur me **252** (22.822 votues në Listën e vitit 2023 dhe 23.074 votues në listën e 10 korrik 2024).

Nga të dhënat e DPGJC vërejmë se kanë ardhur me vendbanim në Himarë **311** votues nga bashki të tjera, të larguar nga Bashkia Himare nuk rezulton asnjë votues **0**. Dokumentacionet lidhur me transferimet janë ngarkuar ne RKGJC nëpërmjet Portalit e-Albania dhe janë certifikuar nga punonjësit e gjendjes civile.

Tabela e mëposhtme tregon listën e votuesve të transferuar në bashkinë Himarë nga Bashkitë përkatëse në periudhën midis dy listave zgjedhore ( Prill 2023 – Korrik 2024) të hartuara për këtë bashki.

Bashkia origjinë (nga jane transferuar)	Numri i votuesve
Bashkia Tiranë	90
Bashkia Vlorë	68
Bashkia Sarandë	43
Bashkia Fier	17
Bashkia Dropull	14
Bashkia Berat	9

Bashkia Lushnje	9
Bashkia Divjakë	7
Bashkia Kurbin	7
Bashkia Gjirokastër	6
Bashkia Memaliaj	5
Bashkia Prrenjas	5
Bashkia Durrës	4
Bashkia Elbasan	3
Bashkia Konispol	3
Bashkia Patos	3
Bashkia Tepelenë	3
Bashkia Mat	2
Bashkia Pogradec	2
Bashkia Cërrik	1
Bashkia Fushë-Arrëz	1
Bashkia Kamëz	1
Bashkia Kavajë	1
Bashkia Krujë	1
Bashkia Librazhd	1
Bashkia Maliq	1
Bashkia Peqin	1
Bashkia Poliçan	1
Bashkia Roskovec	1
Bashkia Shijak	1
<b>Total</b>	<b>311</b>

#### 4.3. Sistemi i Adresave

Duke u nisur nga problematikat e evidentuara në Sistemin RKGJC në aspektin e adresave edhe nga auditët teknikë të mëparshëm, u konstatua një numër i konsiderueshëm votuesish me adresë të pasaktë (mungesë e përbërësve të adresës) që për rrjedhojë nuk mund të kenë dhe adresën zgjedhore (kodin e vendbanimit ose kodin 10 shifror) të saktë. Nga analiza e informacionit të dërguar nga DPGJC vërehen raste të shumta ku shumë votues janë të regjistruar në njëjtën adresë dhe një numër i madh votuesish me përbërës të mangët në adresë.

Bashkia	Zgjedhes me adresë të pa sakte
Bashkia Himarë	5.615

Statistikat më të dhëna të pasakta tek njësia, ose qyteti dhe numri i zgjedhësve në të.

Bashkia	Njesia	Qyteti	Rruga	Zgjedhes
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Himare	694
Himarë	UNKNOWN	Lukovë	Lukovë	418
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Lukove-sarande	294
Himarë	UNKNOWN	Shënavasil	Shënavasil	250
Himarë	UNKNOWN	Qazim Pali	Qazim Pali	236
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Shen-vasil - Sarande	231
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Himarë	189
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Piqeras-sarande	186
Himarë	UNKNOWN	Piqeras	Piqeras	186
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Qeparo	180
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Gjilek	179
Himarë	UNKNOWN	Borsh	Borsh	157
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Himare	151
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Kudhes	144
Himarë	Himarë	HIMARË	JORGJI BOLLANO 04200032	141
Himarë	UNKNOWN	Nivicë	Nivicë	122
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Nivice - Sarande	111
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Dhërmi	108
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Borsh - Sarande	100
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Dhermi	100
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Lukove - Sarande	94
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Vuno	81
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q---pali-sarande	75
Himarë	UNKNOWN	Vranisht	Vranisht	69
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	#NAME?	63
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q-pali-sarande	61
Himarë	Himarë	HIMARË	XHORXH TENET 04200101	60
Himarë	UNKNOWN	Kuç	Kuç	51
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Palase	50
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Pilur	44
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Sasaj - Sarande	44



Raporti final i Audituesit Teknikien

Himarë	UNKNOWN	Himarë	Qeparo	36
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Gjilek	36
Himarë	Lukovë	QAZIM PALI	PLAZHIT 04400046	35
Himarë	Lukovë	LUKOVË	LUKOVE 04400032	34
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Nivice-sarande	33
Himarë	Himarë	DHËRMI	ALLONJA 04200003	32
Himarë	Lukovë	BORSH	BORSH 04400004	29
Himarë	Lukovë	LUKOVË	GERHOTI 04400013	27
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Fterre - Sarande	27
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Pilur	24
Himarë	Lukovë	QAZIM PALI	SHKOLLES 04400059	24
Himarë	Himarë	HIMARË	2 DHJETORI 04200001	24
Himarë	Lukovë	SASAJ	SASAJ 04400053	23
Himarë	UNKNOWN	Gjilek	Gjilek	22
Himarë	UNKNOWN	Tërbaç	Tërbaç	22
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q. Pali - Sarande	21
Himarë	Lukovë	PIQERAS	PIQERAS 04400043	21
Himarë	UNKNOWN	Çorraj	Çorraj	20
Himarë	UNKNOWN	Sasaj	Sasaj	20
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q---pali--sarande	18
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Çorraj-sarande	18
Himarë	Himarë	PILUR	MILO MERKURI 04200055	18
Himarë	Lukovë	NIVICË	RRUPAQE 04400052	17
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q--pali--sarande	17
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Rruge Panjohur	15
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q--pali-sarande	14
Himarë	Himarë	PALASË	LLOGARA PALAS 04200048	14
Himarë	Lukovë	SHËNVASIL	SHEN VASIL 04400056	13
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Ilias	12
Himarë	UNKNOWN	Fterrë	Fterrë	12
Himarë	Himarë	HIMARË	VANGJEL ZOTO 04200098	12
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Lukove- Sarande	12
Himarë	UNKNOWN	Kallarat	Kallarat	11
Himarë	Himarë	PILUR	ANDREA BALA 04200006	11
Himarë	Horë-vranisht	TËRBAÇ	MIRO TERBACI 04250025	11
Himarë	Himarë	HIMARË	KLEODHORA DHIMALEKSI 04200037	11

Raporti final i Audituesit Teknikien

Disa nga statistikat me të dhëna të pasakta tek përbërësit e adresave dhe numri i zgjedhësve për secilën adresë.

BASHKIA	NJESIA	QYTETI	RRUGA	NDERTESA	HYRJA	APARTAMENTI	K_POSTAR	ZGJEDHES
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Himare				0000	694
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Lukove-sarande				0000	294
Himarë	UNKNOWN	Lukovë	Lukovë	0	0	0	0000	270
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Shen-vasil - Sarande				0000	231
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Piqeras-sarande				0000	186
Himarë	UNKNOWN	Qazim Pali	Qazim Pali	0	0	0	0000	180
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Qeparo				0000	180
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Gjilek				0000	179
Himarë	UNKNOWN	Shënvasil	Shënvasil	0	0	0	0000	179
Himarë	UNKNOWN	Piqeras	Piqeras	0	0	0	0000	166
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Kudhes				0000	144
Himarë	UNKNOWN	Borsh	Borsh	0	0	0	0000	119
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Nivice - Sarande				0000	111
Himarë	UNKNOWN	Nivicë	Nivicë	0	0	0	0000	107
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Borsh - Sarande				0000	100
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Dhermi				0000	100
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Lukove - Sarande				0000	94
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Vuno				0000	81
Himarë	UNKNOWN	Himarë	Dhërmi	018	0	018	0000	75
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q---pali-sarande				0000	75
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	-borsh--sarande				0000	63
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Q-pali-sarande				0000	61
Himarë	Himarë	HIMARË	JORGJI BOLLANO 04200032	16	1		9425	57
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Palase				0000	50
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Pilur				0000	44
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Sasaj - Sarande				0000	44
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Nivice-sarande				0000	33
Himarë	UNKNOWN	Qazim Pali	Qazim Pali	888	0	0	0000	33
Himarë	Himarë	DHËRMI	ALLONJA 04200003	1	1		9422	32
Himarë	UNKNOWN	Panjohur	Fterre - Sarande				0000	27
Himarë	UNKNOWN	Borsh	Borsh	888	0	0	0000	26
Himarë	Himarë	HIMARË	XHORXH TENET 04200101	22	1		9425	25
Himarë	UNKNOWN	Qazim Pali	Qazim Pali	002	00	000	9713	23
Himarë	Himarë	HIMARË	JORGJI BOLLANO 04200032	2	1		9425	21
Himarë	Lukovë	PIQERAS	PIQERAS 04400043	13	1		9713	21
Himarë	Lukovë	QAZIM PALI	PLAZHIT 04400046	21	1		9713	21



## 5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore

Në lidhje me administrimin e procesit të përgatitjes së listës së zgjedhësve konstatohet se:

1. DPGJC ka përgatitur ekstraktin e listës së zgjedhësve më datë 10.07.2024, që është dhe Lista Përfundimtare për këtë rast, afat i cili është në përputhje me kërkesat ligjore.
2. DPGJC ka përjashtuar nga lista zgjedhore 136 votues me moshe mbi 100 vjeç në datën zgjedhjeve.
3. Kërkesës sonë për informacion në lidhje me zbatimin e nenit 52 të Kodit zgjedhor mbi "Njoftimin me shkrim i zgjedhësve" nga ana e DPGJC dhe Bashkia Himarë nuk është realizuar.

## 6. Opinion

Në përfundim të periudhës së auditimit referojmë se nuk kemi hasur vështirësi për te kryer misionin e ngarkuar sipas kodit zgjedhor.

Problematikat kryesore të evidentuara ka të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve me një numër të lartë rendor të kodeve të banesave ose pa adresa te sakta ne sistemin e DPGJC (problematikë e gjetur dhe në raportet e zgjedhjeve të mëparshme) të cilat duhen bërë një kontroll i detajuar në zyrat e gjendjes civile për të parë dokumentacionin përkatës të cilat përdoren për regjistrimin e këtyre zgjedhësve.

Gjate auditit u konstatua një rritje e numrit total te votuesve për bashkinë Himare me **252**. Ndërkohë që numri i votuesve ne listat e vitit 2021 (22.830 votues) krahasuar me listën e vitit 2023(22.822 votues) për këtë bashki ishte zvogëluar me **8** votues. DPGJC duhet te verifikojë dokumentacionin e transferimeve nëse janë kryer në përputhje me ligjin.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile duhet të marrë masat për njoftimin e zgjedhësve dhe lehtësimin gjetjes së qendrës (vendit) të votimit për votuesit.

Deri në momentin e përpilimit të këtij raporti DPGJC nuk ka publikuar online për konsultim, për qytetaret listën zgjedhore të datës 10.07.2024 për Bashkinë Himarë, akses i cili jepet nëpërmjet portalit e-albania. Në këtë portal vazhdon të jetë lista e zgjedhjeve te vitit 2023.

## 7. Shtojca

